

SALI BERISHA



Datëlindja: 15.10.1944

Vendlindja: Tropojë

Email: Sali.Berisha@parlament.al

Jetëshkrimi:

U diplomua në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë në vitin 1967. Pas diplomimit ai u specializua në kardiologji dhe më pas u emërua si asistent profesor pranë të njëjtit fakultet dhe mjek kardiolog në spitalin universitar “Nënë Tereza”. Ai ka marrë pjesë në disa specializime në spitale dhe klinika të huaja si në spitalin Clichy në Paris.

Më 1986 u zgjodh anëtar i Komitetit Evropian për Kërkime në Shkencat Mjekësore. Karriera politike e z. Berisha nisi me Lëvizjen Studentore të Dhjetorit 1990. Më 1991-1992 ai ka qenë deputet përfaqësues i Partisë Demokratike. Prej vitit 1992-1997 ka qenë President i Republikës së Shqipërisë. Në periudhën 1997-2005 z. Berisha ka mbajtur postin e Kryetarit të Partisë Demokratike dhe ka qenë deputet i kësaj partie në Kuvendin e Shqipërisë.

Në vitet 2005-2013 ai ka qenë Kryeministër i Republikës së Shqipërisë dhe deputet përfaqësues i Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë. Nga 2013-2019 ai ka qenë deputet i Partisë Demokratike.

Prej viteve '70 ai ka marrë pjesë në punë kërkimore si dhe ka publikuar libra studimorë, tekste universitare dhe shumë artikuj shkencorë në fushën e kardiologjisë brenda dhe jashtë vendit. Z. Berisha mban titullin shkencor “Profesor Doktor”.